Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1119/20
Datë/Datum. 31.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksper. shqyrtues dhe nënshkrimi:	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës:*
Ermal Shala:	21/12/2020	31/12/2020	*1119/20*

1. BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 21.12.2020, **OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë**, ka parashtruar ankesë me nr: 1119/20, kundër njoftimit për shpërblim me kontratë dhe refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së, për aktivitetin e prokurimit numër **"622-20-6037-1-1-1"**, me titull **Furnizim me invetar për nevojat e Komunës së Prizrenit**, iniciuar nga **AK – Kuvendi Komunal i Prizrenit – Prizren.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, vlerë e mesme, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **200,000.00€.**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:
Data e përgatitjes së njoftimit për kontratë: 12.10.2020
Afati i fundit për dorëzim të ofertave: 20.11.2020
Vendimi i AK-së dhe letrat standarde: 01.12.2020
Kërkesa për rishqyrtim pran AK: 05.12.2020
Përgjigja në kërkesën për rishqyrtim: 10.12.2020
Ankesa në OSHP: 21.12.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të LPP-së, Ekspertet Shqyrtues ka shqyrtuar pretendimet ankimore.

2. DISPOZITAT E SHKELURA NGA AK DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë, pretendon se gjatë kësaj procedure të prokurimit, nga ana e AK-së janë shkelur këto dispozita të Ligjit 04/L-042; 04/L-237; 05/L-068; dhe ligjit 05/L-092.

Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 41 i Rregullave dhe udhëzuesit të prokurimit

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET ANKIMORE

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesat a).Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 .Neni 65. b)Në dokument nga Administra Tatimore e vendit tuaj të themelimit,se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. c)Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmeris të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës d një dëshmi se ju keni përmbushë obligimet e tatimit në pronë së paku deri në muajin paraprak nga data e hapjes së ofertave	**a. Deklarata nën betim e cila është pjesë e DT të plotësohet nënshkruhet dhe vuloset në original b).Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje). c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Qështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit). D. Vërtetimi i tatimit në pronë Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues,para publikimit të dhënies së kontratës.Në rast të dështimit në dorzimë të dokumentave të tilla,tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar**
Përshtatshmëria profesionale	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i Numrit Fiskal Kërkesa 3 OE duhet të jetë i regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH së	**Evidenca 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje). Evidenca 2 Certifikata e numrit fiskal Evidenca 3 Qertefikata e TVSH së**
Kapaciteti ekonomik dhe financiar	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
3. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjat tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se 400.000,00 €	**Evidenca 1 Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.**
Kapaciteti teknik dhe professional	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 300.000,00 € Kërkesa 2 Të ketë së paku 10 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës Kërkesa 3 .E.duhet të prezentoj produktet e	**Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të furnizimeve. Dëshmija 2 . Lista e të punësuarve e paraqitur në ATK në tre muajt e fundit bashk me përshkrimi I shkurtër I vendit të punës për stafin, ose**

kërkuara sipas DT dhe përshkrimit teknik në paramasa, në formë katallogu-Broshure. Kërkesa 4. OE duhet të jetë i qertefikuar edhe për këto kategori a. Certifikim OHSAS 18001 për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë b. ISO 9001 2015 -Sistemi i menaxhimit te cilësisë c. ISO 14001 -Sistemet e menaxhimit të mjedisit Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të plotësojë minimum 60 % lërkesave ekonomiko financiare dhe teknike e profesionale të referenceave të natyrës së kontratë	**kontratat e bashkëpunimit në të cilat duhet të ceket titulli i këtij projekti si dhe vlefshmëria së paku sa kohzgjatja e realizimit të këtij projekti .Dëshmija 3 O.E. duhet te prezentoj tek A.K. për secilin produkt nga një(1) FOTO për produktet e ofruara sipas specifikave teknike te kërkuara nga AK dhe karakteristikave në DT dhe NJK në formë Katallogu - broshure-ORIGJINAL e nënshkruar dhe vulosur nga O.E.dhe te prezentohet vizatimi teknik i produkteve ku do te prezentohet edhe dimenzionet dhe kualiteti. Dëshmija 4. Certifikim OHSAS 18001 për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë b. ISO 9001 2015 -Sistemi i menaxhimit te cilësisë c. ISO 14001 - Sistemet e menaxhimit të mjedisit**

Autoriteti Kontraktues ka shpallur tenderin në fjalë në të cilin ka paraqitur kërkesat për pjesëmarrje si dhe ka paraqitur kriterin për dhënie i cili ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët me poenton, ndërsa ne si Operator Ekonomik i jemi përgjigjur lleseës për tender duke e përgatitur tenderin dhe duke ia bashkangjitur të gjitha dokumentet e kërkuara nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Pasi kemi kontrolluar vendimin e autoritetit kontraktues, për dhënie të kontratës, si dhe pasi kemi pranuar letrën standarde me të cilën jemi njoftuar si tenderues i pa suksesshëm, duke u bazuar në nenin 10 të LPP-s kemi kërkuar qasje në dokumentacionin tenderik. Pasi kemi analizuar dokumentacionin e tenderuesit të cilin AK ka vendosur që ta shpërblej me kontratë, vërejtëm se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të LPP-së gjatë vlerësimit, pasi që gjatë vlerësimit, nuk i ka zbatuar kërkesat të cilat vet Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Tek kushtet e vegjëta në nenin 3.4.5 shtë paraqitë që Perindha garantuese e defekteve është 2 vite. Pasi kemi ekaminuar deklaratën për garancion te paraqitur nga O.E. i rekomanduar per kontratë kemi vërejtur se ka ofruar deklaratën për garancion per një afat prej 12 muajve.

Nga një qasje e tërë me lartë shihet se Operatori Ekonomik i rekomandohet nuk do të ofronte materiale krahasuese sipas i shënojnë kërkesat e AK-së dhe si do të paraqitej detyrimi [illegible]

Tek Seksioni II, FLETA E DHENAVE TË Tenderit (FTD) në nenin 7.1 & 7.2 AK ka paraparë kërkesat e përshtatshmërisë profesionale ndër të cilat, ne pikën 1 ka vërtetuar që: 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit. Ndërsa si dëshmi ka kërkuar: Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje). Pas ekzaminimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të O.E. të cilin A.K. ka mendur që ta shqërbiej me kontratë vërejtëm se anëtari i grupit të O.E. Samire Osmani B.I. nuk e ka në aktivitet të biznesit veprimtarinë e mobiljeve dhe inventarit. Vetë kërkesa e përshtatshmërisë është bërë me qëllim të dëshmisë se grupi i O.E. i plotëson kërkesat e paraqitura nga AK. Pra ky grup nuk e ka plotësuar këtë kërkesë.

Tek Seksioni II, FLETA E DHENAVE TË Tenderit (FTD) në nenin 9.1 & 9.2 AK ka paraparë kërkesat mbi mundësitë teknike dhe ose profesionale ndër të cilat në pikën 2 ka kërkuar që: Kërkesa VOJ duhet të prezentoj produktet e kërkuara sipas DT dhe specifikimit teknik në paramasa, në formë Katalogu-Broshure. Ndërsa si dëshmi ka kërkuar: Deklarata [illegible] duhet të prezentohet [illegible] specifike [illegible] (FTD) [illegible] për produktet e ofruara sipas specifikave teknike të kërkuara nga AK dhe karakteristikave në DT dhe NJK në formë Katalogu - broshure-FOTOGRAFI - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E.dhe të prezentohet vizatimi teknik i produkteve ku do te prezentohet edhe dimenzionet dhe kualiteti.

Nga ekzaminimi i katalogut të paraqitur nga grupi i O.E. të rekomandoar vërejtëm që në shumicën e artikujve ky grup nuk ka dhënë shënimet e kërkuara nga AK për vizatimin teknik të produkteve edhe dimenzionet siku është kërkuar nga AK për specifin produkt të kërkuar në dosjen e tenderit dhe përshkrimin e çmimeve.
Grupi i O.E. ne disa artikuj ka paraqitur vetëm dimensionet pa vizatim teknik duke i kopjuar nga specifikat teknike në dosje të tenderit, ndërsa për artikujt në vijim edhe pse është kërkuar nga AK, nuk ka paraqitur kurrëfare vizatimi apo dimensioni:
B-A23.3; B-A24.1; B-A24.2; B-A24.3; B-A24.4; B-A25.1; B-A25.2; B-A25.3; B-A25.7; B-A26.2; B-A26.3; B-A26.4; B-A26.6; B-A27.3; B-A27.4; B-A27.5; B-A27.6; B-A27.7; B-A27.8; B-A28.1; B-A28.2; B-A28.3; B-A28.4; B-A28.5; B-A28.6; B-A29.2; B-A29.3; B-A29.4; B-A29.5; C-A30.1; C-A31.1; C-A32.1; C-A33.1 dhe C-A35. Pra sikur lexojmë me lartë grupi i O.E. i rekomandoar për 34 produkte nuk ka ofruar vizatimet teknike me dimensionet e produkteve te ofruara.

Gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit te tenderit te dorëzuar nga grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar nga ana e AK-s, vërejtëm se grupi nuk e ka dorëzuar fare çertifikatën OHSAS 18001 për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë të kërkuar në dosje te tenderit tek Seksioni II, FLETA E DHENAVE TË Tenderit (FTD) në nenin 9.1 & 9.2 tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe ose profesionale në pikën 4. Në këtë pikë kërkesa ka qenë si në vijim: 4. OE duhet te jetë i çertefikuar edhe për këto kategori a. Certifikim OHSAS 18001 për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë b. ISO 9001 - 2015 -Sistemi i menaxhimit te cilësisë c. ISO 14001 - Sistemet e menaxhimit të mjedisit. Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të plotësojë minimum 60 % të kërkesave ekonomiko financiare dhe teknike e profesionale të referencave të natyrës së kontratës.

Pas ekzaminimit vërejtëm se lideri ka dorëzuar vetëm certifikatën ISO 9001 - 2015 -Sistemi i

minimumit te cilësisë. Kërkesës e Autoritetit Kontraktues sikur vërejtet më larte ka qenë që ne pasi të krijimit të konsorciumit OE, bartës duhet të plotësojë minimum 60 % të kërkesave ekonomiko financiare dhe teknike e profesionale te referencave të natyrës së kontratës. Duke e bërë një kalkulim te thjeshtë del se vetëm 33% të ISO-ve i ka plotësuar ideni. Ndërsa certifikatat gjeni ISO te cilat e përbëjnë 67 përqindëshin, janë dorëzuar nga anëtari i konsorciumit e që këto certifikata nuk janë të vlefshme për këtë procedure te prokurimit, pasi që anëtari i grupit eshtë certifikuar për shërbime te Dezinfektimit, Deratizimit dhe Dezatizimit dhe jo për lëmin e prodhimit dhe mbrojtjes e dhe inventarit sikur janë certifikuar ne Autoritetit Kontraktues me e ka gjetur paqëso [illegible] dhe jo [illegible] e [illegible] dhe [illegible] per kapacitet.

Gjë [illegible] e [illegible] profesionale, eshtë kërkuar [illegible] referencat te natyrës se njejtë ne vlerë prej [illegible] Disa nga referencat janë dhënë nga ideri i grupit "Trend Home" SH.P.K. ndërsa disa tjera janë dorëzuar ne emër te "Gold Invest" apo operonin emër i cili nuk eshtë anëtar i grupit te paraqitur ne këtë tender.

Duke u bazuar ne atë që u tha me larte, AK ka bërë vlerësim jo te drejtë dhe ne kundërshtim me nenin 59 te LPP-s sa i perkete certifikatave ISO sepse ka pranuar si te vlefshme certifikatat e dorëzuara nga anëtari i grupit Samire Osmani BI e cila nuk eshtë e certifikuar per mobilje dhe inventar por per shërbime D.D.D. Gjithashtu e ka pranuar katalogun i cili nuk eshtë plotësuar sikur eshtë kërkuar ne dosje te tenderit dhe njoftimin per kontratë pasi që 34 artikujt nuk i ka paraqitur me vizatime teknike dhe dimensione, shumica e referencave janë dorëzuar ne emër te një O.E. i cili nuk ka qenë anëtar i grupit, si dhe nuk e ka dhënë atestin e garancisë per një periudhë prej 24 muajve.

Me dispozitën e paragrafit 1 te nenit 59 te LPP-s shprehimisht eshtë paraparë që Autoriteti Kontraktues do te kërkojë nga tenderi i përfituesit [illegible] ne fjalë eshtë [illegible] AK ka kërkuar [illegible] O.E. i cili nuk i plotësonte kërkesat e larëpërsëruri edhe pse janë paraqitur ne dosje te tenderit dhe njoftimin per kontratë. Sipas nenit 41 te Rregullave dhe Udhëzuesit te Prokurimit, vetëm O.E. te cilat i plotësojnë kërkesat e Autoritetit Kontraktues konsiderohen te përgjegjshëm. Andaj konsiderojnë që Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje te nenit 59 te LPP-s dhe Nenit 41 te Rregullave dhe Udhëzuesit te Prokurimit, si dhe duke mos i trajtuar ne mënyrë te barabartë te gjithë O.E. pasi që ka favorizuar O.E. te rekomanduar, ka bërë edhe shkelje te nenit 7 te LPP-s.

Duke u bazuar ne nenin 106 te LPP-s, si dhe ne vërtetimet dhe faktet e cekura me larte, kërkojnë nga OSHP që te urdhëroj Autoritetin Kontraktues, automatikisht ta pezullojë aktivitetin e prokurimit ne fjalë, te shqyrtoj faktet e paraqitura ne ankesën tonë dhe pas vërtetimit te fakteve te cekura me larte ta urdhëroj Autoritetin Kontraktues që ta zbatoj vendimin e Panelit Shqyrtues PSH Nr. 896/19 *dhe te na shpërblen neve me kontratën ne fjalë si konsorcium i cili ka dorëzuar tender te përgjegjshëm me cmimin me te ulët.*

4. RAPORTI I KOMISIONIT RI-VLERËSUES

N/A

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË ANKESËS

Përgjigje në pretendimet ankimore te OE ankues

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit në detaje të pretendimit të OE ankues, analizimit të DT, NJK, specifikacionit teknik, përshkrimi i çmimeve vendimeve të AK, kërkesave për sqarime dhe fakteve të kësaj ekspertize mendon që AK nuk ka vepruar në kundërshtim me nenët 7, 59 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1:
Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të **OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë** lidhur me ofertën e tyre nga AK KK Prizren, tek kushtet e veqanta është kërkuar garancioni për dy vite, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar deklaratë për garancion prej 12 muaj. Por meqenëse AK-KK Prizren nuk e ka vendosur këtë kriter tek kriteret e njoftimit për kontratë dhe kriteret ne Fleten e Te Dhenave të Tenderit FDT lidhur me kërkesat për garancion prej 2 vite. Kjo nuk mund të konstatohet se kualiteti i produketeve nuk është apo është i mirë. Në këtë rast AK ka shpallur fitues një OE i cili ka emime të peshuara për 50% më të lira në krahasim me ofertën ankimore në përputhje me nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së. Në cilësinë e eksperti i sygjeroj AK – KK Prizren që para nënshkrimit të kontratës me cilindo nga oferatorët të shiqohen kushtet e garancionit, dhe kërkesat për sigurmin e garancionit të ekzekutimit. Ky pretendim **është pjesërisht i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin ankimor 2:
Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të **OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë** mbi pretendimet për shkeljen e pikave 7.1 & 7.2 mbi kërkesën e përshtatshmërisë për OE Samire Osmani B.I., pretendimi se nuk i plotëson kërkesat tek 7.1 & 7.2 Regjistri si operator ekonomi në profesional dhe komercioal dhe apo Regjistrin e ndermarrjeve ne vendin e juaj të themelimit. Nuk qëndon pasi O.E. Samire Osmani B.I. pjesë e konzorciumit Trendy Home SHPK & Samire Osmani B.I. ka dorëzuar Certifikatat sipas pikës 7.1 & 7.2 dhe konzorciumi krijohet për arsye kur një OE nuk mund ti plotësoj kriteret apo kushtet e një projekti dhe antarët së bashku i plotësojnë. Nuk ka qenë kriter në NJK dhe DT që OE duhet të kenë të regjistruar veprimtarine e mobileve, por edhe po të ishte si kriter ky kriter plotësohet nga bartësi i konozrciumit Trendy Home sh.p.k. Ky pretendim **është i pa bazuar**

Përgjigje në pretendimin ankimor 3:
Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të **OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë** mbi pretendimet për shkeljen. Grupi i OE i shpallur fitues ka dorëzuar katallogun e nënshkruar dhe vulosur origjinal, si dhe në katallog specifikohen dimenzionet, foto dhe përshkrimi i materialit sipas kërkesës në NJK dhe DT. AK – KK Prizren në përputhje me nenin 59.3 dhe nenin 72 ka mundur të kërkoj sqarime shtesë nga OE. Ky pretendim **është pjesërisht i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin ankimor 4:
Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të **OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë**, lidhur me pretendimin se grupi i OE i shpallur fitues lider duhet të ketë 60% ekonomike financiare dhe teknike e profesionale, sqaron se Lidhur me Certifikimet ISO OHSAS 18001, ISO 9001 2015, ISO 14001, nuk është kërkesë specifike në NJK, DT që bartësi i konzorciumit duhet të ketë domosdoshmërisht 60% të kërkesave në certifikatave ISO, Certifikimet ISO janë pjesë e dokumentacioneve të cilat lidhen me aspektin profesional, teknik e profesional. Andaj lidhur me këtë pretendim që lideri i konzorciumit nuk i

posedon 60% të certifikimeve ISO, mjafton që certifikimet ti ketë lideri apo ndonjë antar i grupit. Lidhur me Certifikimin OHSAS 18001 pas verifikimeve në organizatën www.iso.org sqarohet se standardi ISO OHSAS 18001 nga marsi 2018 zëvendësohet me standardin e ri ISO 45001. Nga marsi 2021 standardi ISO OHSAS 18001 do të migrohet plotësisht në ISO 45001. Ky pretendim **është i pa bazuar**

Përgjigje në pretendimin ankimor 5:
Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të **OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë** mbi pretendimet për shkeljen, sa i perket kërkesave mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale, është kërkuar që O.E. të ketë referenca të natyrës së njetë në vlerë 300,000.00 Euro. Pretendimi se disa referenca nga lideri i grupit Trendy Home SHPK, ndërsa disa tjera janë dorëzuar në emër të "Gold-Invest" një operator tjeter i cili nuk është pjesë e konzorciumit i paraqitur në këtë tender. Pas analizimit dhe verifikimit për pretendimin sqarohet se Gold Invest shpk dhe Trendy Home shpk janë i njejti biznes, mirëpo biznesi nga themelimi ka operuar me emrin Gold Invest, ndërsa nga data 10.04.2018 ka vendosur të ndryshoj emrin e biznesit në Trendy Home, me vendime dhe sipas procedurave të cilat rregullohen në ARBK. Referencat dhe kontratat duhet të merre përbazë pasi është i njejti biznes dhe vetëm ka ndryshuar emrin. Ky pretendim **është i pa bazuar**

Eksperti shqyrtues teknik sqaron që AK ka vepruar duke respektuar nenët 1, 6, 7, 59, të LPP-së.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet dhe të gjeturat në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet **si pjesërisht të bazuar** dhe **të mbetet në fuqi vendimi i AK** për këtë aktivitet të prokurimit.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues: **AK – Kuvendi Komunal i Prizrenit – Prizren**
- Panelit Shqyrtues OSHP
- OE ankues **OE "MOBELLAND" SH.P.K. – Suharekë**